



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

Nr. _____ .Prot

Bajram Curri me 19.12.2018

V E N D I M

Nr.187, Date 19.12.2018

**“PËR MIRATIMIN E PBA-SË 2019-2021, BUXHETI DHE NUMRIT MAKSIMAL TË
PUNONJËSVE TË
BASHKISË TROPOJË PËR VITIN 2019, SI VITI I PARË I PBA-SË 2019-2021”**

Këshilli i Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tij të datës 19.12.2018, me propozimin e kryetarit të bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 54 shkronja “dh” dhe neni 55 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 6, 15, 17, 32 dhe 44 i Ligjit nr. 9936, datë 28.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; neni 6, shkronjat “ç” dhe “d”, neni 33, neni 40, neni 41, pika 1 dhe 3 të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin; Udhëzimit nr.10 datë 29.02.2017 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”; Udhëzimit nr.10/1 datë 29.02.2017 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”; Udhëzimi i MF nr.10/1 date 28/02/2017 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”; Shkresa e Ministrisë të Financave Nr.19369 Prot, date 30.10.2018 “Dergim për njoftim transferta e pakushtezuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2019”, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Të miratoje numrin e përgjithshëm të punonjesve të Bashkisë, sipas tabelës nr. 1, për vitin 2019.
2. Të miratoje burimet financiare të Bashkisë Tropojë, sipas tabelës nr. 2 për vitin 2019 dhe PBA-në 2019-2021.
3. Të miratojë shpërndarjen e burimeve financiare për vitin 2019, sipas programeve dhe funksioneve, sipas tabelës nr 3, për vitin 2019, dhe PBA-në, 2019-2021.
4. Të miratojë tabelën e investimeve sipas tabelës nr. 4, për vitin 2019, dhe PBA-në, 2019-2021.

5. Të miratojë krijimin e fondit rezervë dhe kontigjencës, kujdesit social dhe buxhetit gjinor sipas tabelës nr. 5, për vitin 2019 dhe PBA-në 2019-2021.
6. Të miratojë detajimin e shpenzimeve operative për vitin 2019, nga Transferta e Pakushtëzuar dhe të ardhurat dhe Transferta Specifike.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Keshillin Bashkiak Tropojë:

SEKRETARI

Rubin Sellaj

KRYETARI

Imer HOXHA